

**VENDIM**  
**Nr.95, datë 11.2.2005**

**PËR REGJISTRIMIN NË REGJISTRIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME, NË EMËR TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË TRUALLIT NË GJIRIN E VLORËS, DHËNË ME  
KONCESION SHOQËRISË “LA PETROLIFERA ITALO-ALBANESE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, pikat 1 e 2 shkronja “a”, 10, 13 e 14 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” dhe të nenit 38 të ligjit nr.7843, datë 17.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Regjistrimin në regjistrin e pronave të paluajtshme, në emër të Republikës së Shqipërisë, të truallit në gjirin e Vlorës, me sipërfaqe 183 000 m<sup>2</sup>, të kufizuara në verilindje me ish-uzinën e Sodës dhe atë të PVC-së, në veriperëndim me territorin e portit të ri, në juglindje me Pyllin e Sodës dhe në jugperëndim me detin, dhënë me koncesion shoqërisë “La Petrolifera Italo-Albanese”, sipas ligjit nr.9231, datë 13.5.2004 “Për ratifikimin e marrëveshjes së koncesionit, të formës “BOO”, për ndërtimin dhe shfrytëzimin e terminalit bregdetar, për depozitimin e naftës dhe të nënprodukteve të saj në Gjirin e Vlorës, si dhe për ratifikimin e marrëveshjes së koncesionit, të formës “BOT”, për ndërtimin dhe shfrytëzimin e infrastrukturës portuale, në shërbim të terminalit bregdetar në Gjirin e Vlorës”, sipas hartës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë për administrimin e këtij trualli.

3. Ngarkohet Ministri i Ekonomisë dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fyqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**

